

DEMOKRACIA



SISTEM I PAQËS

LIRIA PËR TË ZGJEDHUR

ELSA (14), DITION (14), AURORA (14), NORA (14), MARIGONA (14), ELONA (14)

Dëshira e një qytetari mund të shprehet përmes votës

Zgjedhjet e një shteti zhvillohen në një periudhë të caktuar kohore. Qytetarët kanë të drejtë t'i zgjedhin personat që do ta përfaqësojnë vendin, do të thotë t'i zgjedhin deputetët. Periudha kohore e qeverisjes quhet mandat dhe mandati i deputetëve në Kosovë zgjatë katër vjet. Ligji në Kosovë përcakton se qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e zgjedhjeve kur të mbushin 18 vjeçare. Parregullësi në votim quhet kur qytetari voton më shumë se një herë ose voton dy e më shumë parti. Përgjegjësia e një deputeti të zgjedhur nga qytetarët është që të mbajë premtimet e dhëna.



Grupi punues

Sa mirë do të ishte që kjo fabrikë të funksionalizohej



Dëshira e qytetarëve

Po votoj, me shpresën që kërkesat tona të realizohen



Qytetari duke votuar

Kjo fabrikë do të rindërtohet dhe do të hapen vende pune.




Deputetja e zgjedhur



Qytetarët duke punuar në fabrikën e premtuar

DEMOKRATËT E VEGJËL

ERA (14), DONJETA (14), MIGENA (15), ELDI (14), LEART (14), DIELLZA (14)



Artikulli ynë flet për demokracinë, për vlerat e saj dhe rolin tonë në të

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke dhe përbëhet nga dy fjalë të cilat janë: „demos“ që do të thotë popull apo dhe „kratia“ që do të thotë qeverisje. Ne, si qytetarë, jemi fryti i pemës së madhe të quajtur demokraci, ku ujitemi nga Kushtetuta e Kosovës, pjesë e së cilës janë ligjet, të cilat i kemi për detyrë t’i respektojmë.

Aq sa të drejta gëzojmë, aq përgjegjësi duhet pasur. Si themel i demokracisë, ne do t’i trajtojmë të tjerët ashtu si ne dëshirojmë të na trajtojnë ata neve. Për shkak se bëjnë pjesë edhe komunitete të ndryshme, ndjesinë e respektit e ngrohtësisë duhet ta përjetojnë edhe ata. Ne si fryt i demokracisë, duhet të jemi kontributdhënës duke filluar nga institucioni shkollor, shtëpia, qyteti, e deri tek shteti, kontinenti, e i tërë planeti. Andaj thjeshtë, duhet të punojmë për më shumë se kaq sa kemi, e të jemi krenarë për këta që jemi. Ne mendojmë se mënyrat se si ne mund të marrim pjesë në demokraci janë:

NË PLANETIN TOKË:

Të mbrojmë ambientin nga ndotja dhe faktorët e tjerë të pavolitshëm, më saktë: ngrohja globale.

NË SHPETI:

Të kemi hapësirë që t’i shprehim dëshirat apo men-

dimet tona në tubime të ndryshme, si: peticione, protesta, por gjithmonë me mision i cili i mbron të gjithë.

NË SHKOLLË:

Të marrim sa më shumë njohuri dhe të edukohemi në frymën më të mirë të mundshme. T’i duam mësimdhënësit tanë dhe të jemi mirënjohës për punën e tyre. Me shokët dhe shoqet të jemi të afërt, mirëkuptues dhe shumë të dashur. Ta mirëmbajmë ambientin shkollor dhe të jemi paqësorë me të tjerët.

NË SHPETI:

Ta mirëmbajmë ambientin tonë të dashur, shtëpinë dhe me të gjithë anëtarët të jemi të afërt, ndihmë dhënës në mënyrë që edhe ata të jenë qytetarë të ndershëm dhe aktiv.



Krijuesit e artikullit

NDARJA E PUSHTETIT

DINA (14), JONË (14), RINESA (14), DIANA (14), ERIS (14), DIJAMANT (14)

Ndarja e pushtetit në Kosovë: Kuvendi - Pushteti Legjislativ, Qeveria - Pushteti Ekzekutiv dhe Gjykata - Pushteti Gjyqësor

Kuvendi është Pushteti Legjislativ. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, e prej tyre 20 i takojnë komuniteteve jo shumicë. Disa nga rolet e Kuvendit janë: miratimi i ligjeve, miratimi i buxhetit të Kosovës, zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit të Kuvendit dhe zgjedhja e Presidentit.

Në Kuvend marrin pjesë partitë e pozitës dhe opozitës. Qeveria ndryshe quhet Pushteti Ekzekutiv. Qeveria përbëhet nga Kryeministri dhe ministrat. Roli i Qeverisë lidhet ngushtë me Kuvendin, sepse Qeveria i propozon ligjet, buxhetin dhe është përgjegjëse për zhvillimin e ekonomisë.


Ne sot kemi mësuar që pushteti i tretë është Pushteti Gjyqësor. Pushteti gjyqësor ndahet në: Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme.



Autorët



Nxënësit duke punuar



Pema e mendimeve



PËRGJEGJËSITË TONA PËR DEMOKRACINË

YLLI (14), EULONA (14), AGNESA (14), RINA (14), DIONI (14), DINETA (13)

Ne jemi nxënësit e klasës IX-2 nga Faik Konica dhe sot kemi bërë intervista me qytetarët e Prishtinës për përgjegjësitë tona për demokracinë. Gjithsej i kemi intervistuar 8 persona. Lexim të mbarë!

Që të funksionojë demokracia në një shtet duhet të ketë disa themele të cilat e formojnë atë. Një ndër shtyllat kryesore që e formon atë është shkollimi sepse pa të nuk ka vlerë demokracia. Ne si qytetarë dhe individ aktiv, duhet të jemi të sinqertë dhe t'i kalojmë barrierat të cilat eliminohen me punën tonë. Ligji është i barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës! E disa nga funksionet themelore të qytetarëve janë mbizotërimi i barazive të llojllojshme pa dallim kombi, race apo feje, sepse në realitet ne të gjithë jemi të barabartë dhe e gëzojmë të drejtën e lirisë e të të shprehurit. Vetëm kështu mund të kemi një të ardhme demokratike. Që e ardhmja të jetë fitimprurëse duhet të ketë vetëbesim!



Grupi që bëri këtë artikull



Që të arrijmë demokraci duhet të jemi aktiv dhe të sinqertë.



Ne duhet të respektojmë ligjin, të drejtat e njeriut dhe të shkollohemi.



Përgjegjësi e qytetarëve është votimi!



Çfarë duhet të bëjë një qytetar për një demokraci të mirë?

Mendimet e qytetarëve

Pyetja që iu është bërë qytetarëve sot



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Faik Konica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë